



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsím

Odeljenje za Obrazovanje

Department for Education



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsím
Odeljenje za Obrazovanje

Raport tremujor i punës

Janar, Shkurt, Mars (2024)

IV. Nr. i prot. 1655 Më 03.04.2024
Bz. prot. Di.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Gjatë tre muajve të parë të vitit 2024 në kuadër të DKA-së u realizuan një varg aktivitete, të cilat ishin të parapara të zhvilloheshin në tremujorin e parë të Planit Vjetor të Punës për këtë vit. Këto aktivitete të zhvilluara gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të shkruara sipas muajve, siç vijon:

Muaji Janar

Në fillim të këtij muaji përgatitëm planin përfundimtar (final) të prokurimit për projektet kapitale, për furnizime dhe për mallra dhe shërbime. Gjithashtu, publikuam edhe Raportin Vjetor dhe Planin Vjetor në web faqen e komunës. Përgatitëm planin e shpenzimit të buxhetit sipas muajve (KESH PLANIN) në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa. Nisëm përgatitjet e paramasave për dy projekte; projektin e furnizimit të shkollave me mjete konkretizime dhe laboratorike dhe projektin e furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra, për të cilat projekte nisëm procedurat e prokurimit, përkatësisht më 29 Janar dhe më 2 shkurt 2024, sipas planit vjetor të prokurimit. Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc rifilluan punimet pas pushimit dimëror.

Në klasat 9-ta, 10-ta, 11-ta dhe 12-ta të SHFMU-ve dhe SHML-ve, vazhduan të mbahen garat shkollore të vlefshme për garën e Olimpiadës së Fizikës në nivel komunal. Procesi mësimor i vlefshëm për gjysmëvjetorin e parë, përfundoi më 12 janar, 2024 dhe gjysmëvjetori i dytë filloi më 24 Janar 2024. Mbajtëm një takim me organizatën YMCA, me përfaqësuesit e së cilës biseduam për realizimin e një projekti që ka të bëjë me organizimin e trajnimeve me nxënës dhe të rinjë të komunës sonë. Në bashkëpunim me DKRS, me pjesëmarrjen e të gjitha shkollave, organizuam dhe mbajtëm Orën e Madhe Letrare në kuadër të manifestimeve "Flaka e Janarit". Së bashku me drejtorin e DKRS-së morëm pjesë në një takim të organizuar nga MKRS dhe MASHTI, ku u diskutua për fillimin e realizimit të projektit "Arti në Shkolla".

Më 31 janar 2024 u mbajt trajnimi i fundit i mentorëve të 25 shkollave fillore të mesme të ulëta nga organizata Kosova Makers League, me ç'rast u bë edhe pranimi i 100 robotëve edukativ (nga 4 për secilin nga 25 shkollat), të cilët u financuan nga komuna jonë.

Muaji Shkurt

Procesi mësimor i gjysmëvjetorit të dytë vazhdoi të mbahet rregullisht në të gjitha shkollat. Ndërkohë, në njërin objekt të Shfmu "Isa Boletini" pati një defekt në kalldajën e ngrohjes qendrore, problem të cilin e rregulluam brenda 24 orëve.

Së bashku me zyrtarët e DKA-së kemi punuar dhe vazhduam të punojmë në verifikimin e kërkesave që kanë të bëjnë me Kontratën Kolektive. Nga Policia kanë filluar të mbahen ligjërata nëpër shkolla, me temë "Pasojat e përdorimit të narkotikëve". Organizuam dhe mbajtëm Garën Komunale të Olimpiadës së Fizikës, në të cilën morën pjesë nxënës të mirë të klasave 9, 10, 11, 12.

Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc, kanë vazhduar punimet. Në Xërxë ka vazhduar ndërtimi i mureve të brendshme, ndërsa në Ratkoc ka vazhduar puna në montimin e xhamave të dritareve. Morëm pjesë në lansimin e platformës së mësimi "MOODLE" – Projekt ky i cili do të fillojë së zbatuari edhe në shkollat e komunës sonë. Organizuam aktivitete me nxënës në nderim të 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës, siç ishin vizitat monumenteve kulturo-historike dhe në vendlënit e dëshmorëve e gjithashtu edhe programe festive në shkolla dhe në programin qendror festiv. Më 24 shkurt, 4 nxënës fitues të Garës Komunale në Fizikë i dërguam në Prishtinë për të marrë pjesë në Garën Shtetërore. Nga 4 nxënës fitues të Garës Komunale në Fizikë që morën pjesë në Garën Shtetërore, dy prej tyre treguan sukses të lakmueshëm. Nxënësi i klasës së 12 zuri vendin e tretë, ndërsa nxënësi i klasës së 9 zuri vendin e dhjetë, në nivel vendi. Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, është punuar në sallën e edukatës fizike të Shfmu "Bekim Sylka" ndërkohë jemi angazhuar për t'i bërë gati paramasat për riparime të brendshme në disa objekte të tjera shkollore.

Muaji Mars

Në Gexhë kemi përfunduar projektin e efijencës së energjisë, ndërsa në Çiflak filluan punimet në rregullimin e fushës sportive në oborrin e shkollës, projekt ky i DKA-së. Kemi nisur procedurën e prokurimit për projektin e ndërtimit të rrethojave të oborreve të shkollave. Në kuadër të projektit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të brendshme është punuar në rregullimin e nyjeve sanitare në objektet e shkollave në Drenoc, Senoc dhe në objektin e IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici".

Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Profesionale të Informaticientëve të Kosovës (SHPIK) për fillimin e zbatimit të Projektit të Kodimit në Fushën e Teknologjisë Informative. Është lidhur kontrata për projektin e furnizimit të shkollave me mjete konkretizimi

dhe laboratorike dhe kemi filluar procedurën e prokurimit për projektin e ndërtimit të rrethojave të oborrëve të shkollave.

Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc, kanë vazhduar punimet. Në Ratkoc ka vazhduar puna në suvatimin e mureve të brendshme, ndërkohë ka filluar edhe izolimi dhe fasadimi i mureve nga pjesët e jashtme.

Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, është punuar në sallën e edukatës fizike të SHFMU "Bekim Sylka" ndërkohë jemi duke bërë gati paramasat për riparime të brendshme në disa objekte të tjera shkollore. Në kuadër të projektit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të brendshme është punuar në rregullimin e nyjeve sanitare në objektin e IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici". Ka filluar furnizimi me inventar i 3 çerdheve të reja. Fillimisht, furnizime u bënë në Çerdhen për Fëmijë në Krushë të Madhe dhe më pas vazhdoi furnizimi për Çerdhen e Fëmijëve në Ratkoc. Më 31 mars u përfundua fusha e re sportive në oborrin e SHFMU "31 MARS" në fshatin Guri i Kuq.



Avni Morina
Avni Morina
Drejtor i DKA-së